



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/

AGENCY OF GENDER EQUALITY



**Raporti i Komisionit për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare për OJQ dhe
Lista preliminare e përfituesve**

**Masa 10 "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të
gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4 e Fazës
së dytë**

Agjencia për Barazi Gjinore/ ZKM ka bërë thirrje me datën 28 Janar 2021 për mbështetje financiare për OJQ për përfitim nga Masa 10 "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4 e Fazës së dytë.

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Programin për Rimëkëmbje Ekonomike, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023, me qëllim ruajtjen e shëndetit publik dhe ekonomik të vendit në situatën e krijuar nga COVID-19 dhe vendimin e Qeverisë nr 06/58 datë 14.01.2021 për Zbatimin e Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike për vitin 2021 Masa 4 për mbështetjen financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë përmisimin e pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi dhe vendimit nr 04-59 të datës 27.01.2021 dhe nr 06/60 të datës 27.01.2021 të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, ABGJ shpallë listën preliminare e përfituesve të shqyrtuar nga Komisioni vlerësues për përzgjedhjen e projekteve¹ për mbështetje financiare të OJQ , Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021.

¹ Vendimi i KE ABGJ për themelimin e Komisionit vlerësues për vlerësimin e projekteve të OJQ të grave dhe bizneseve të vogla të udhëhequra nga gratë për "Mbështetje financiare për projektet dhe iniciativat që synojnë fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri dhe ekonomi - Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021" – Masa 4, nr 026/21 datë 29.01.2021

Në bazë të shqyrtimit nga ana e Komisionit për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare, Komisioni ka marrë në shqyrtim:

- Gjithsejtë 91 kërkesa (projekte aplikuese) për mbështetje financiare, nga OJQ- të

Pas shqyrtimit, Komisioni në bazë të dokumenteve të dorëzuara nga secili aplikant dhe në bazë të kriterëve të vendosura për zbatimin e Masë 10-të faza 2 – masa 4 , bazuar në Rregulloren 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe legjislacionin në fuqi vendosi si më poshtë:

- Nga projektet e vlerësuara, Komisioni në përputhje me paragrafin 4 të nenit 18 të Rregullores MEF 04/2017 mbi kriteret ,standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ ka vendosur që
- **24 projekte** shpallen në listën preliminare të përfituesve.
- **28** prej tyre i kanë plotësuar kriteret procedurale dhe projektet e tyre janë vlerësuar sipas kriterëve të rregullores për financimin publik të OJQ-ve, mirepo nuk kane piket e mjaftueshme për financim sipas programit për riemkembje Masa 4
- **39** tjera në mungesë të dokumenteve relevante dhe të kërkuara në thirrje janë diskualifikuar.

Lista Preliminare e Përfitueseve

Nr	Emri i OJQ	Emri i Projektit
1	STIKK	She Store - Mbështetja për digjitalizim të bizneseve të grave
2	Rinvest	Mbështetja e sipërmarrjeve të grave për transformim digjital të biznesit
3	Artpolis	Promovimi i të drejtave të grave përmes artit
4	QKSGJ	Adresimi i nevojave të nënave vet-ushqyese dhe grave rome, ashkalike dhe egjiptase në ekonomi
5	OJQ- Agjencia për Zhvillim Rajonal	Fuqizimi dhe përkrahja e grave në agrikulture
6	RROGRAEK	Fuqizimi i grave/ vajzave nga Komuniteti Rome, Ashkali dhe Egjiptase në ndërmarrje në rajonin e Prishtinës, Pejës, Gjilanit dhe Gjakovës
7	Initiative for Kosova Community IKC	Fuqizimi ekonomik dhe social i gruas në kohë pandemie
8	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve- Liria	Fuqizimi ekonomik për integrim social

9	Mundësia	Fuqizimi ekonomik i grave dhe përmiresimi i mirëqenies, përmes mbështetjeve të bizneseve ekzistuese edhe start up planeve
10	Hareja SHPG	Fuqizimi ekonomik përmes ndërmarresisë dhe bizneseve star tup
11	Zana	Fuqizimi ekonomik dhe shoqëror i grave nga zonat rurale në fushën e bujqësisë
12	PLEJADA	Zanati i grave boshnjake Boshqja
13	Medica Gjakova	Fuqizimi dhe rimëkembja ekonomike dhe të drejtat e grave të mbijetuara nga dhuna në baza gjinore dhe dhuna seksuale
14	Jeta Rinore Lipjan	Përkrahja e grave në ndërmarrësi
15	Kosova Women 4 Women	Pjesëmarrja e grave drejt fuqizimit ekonomik
16	RONA	Sinergjik drejt suksesit
17	LADY	Mbështetje për grupet me të rrezikuara të grave dhe përfshirja e tyre në tregun e punës me qëllim mbështetjes dhe zbutjen e pasojave të shkaktuara nga Covid-19
18	Rrjeti i Grave të Kosovës	Përmiresimi i pozitës së gruas në shoqëri dhe ekonomi dhe luftimi i pasojave gjatë dhe pas Covid-19
19	Youth Center Lipjan - LYC	Fuqizimi i grave në afarizëm
20	Iniciativa e Femrës Kosovare	Përkrahja dhe fuqizimi i bizneseve të grave për tejkallimin e sfidave gjatë periudhës së pandemisë
21	Shoqata Afariste e Gruas SHE- ERA	Fuqizimi i gruas përmes vetëpunësimit në rrafshin e Dukagjinit
22	Partners Kosova Center for Conflict	Tejkallimi i cenueshmërisë nga Covid-19 përmes fuqizimit ekonomik të gruas
23	Bussines Support Center Kosovo BSCK	Fuqizimi i grave ndërmarrëse për të përballuar sfidat nga Covid -19
24	OAPA	Zhvillimi i shkathtësive për gratë dhe vajzat në rajonin e Prizrenit


Bazuar në pikën 2 të nenit 20 të Rregullorës së MF me nr 04/2017 mbi Kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Komisioni ka kërkuar nga ABGJ që aktivitetet dhe buxheti të rishikohen në rastet e caktuara, bazuar në fondet në dispozicion.

OJQ që kanë aplikuar kanë të drejtën e ankesës me shkrim në Komisionin e ankesave në Agjencinë për Barazi Gjinore nga data 15.03.2021 deri me datën 19.03.2021 në orën 15.00. Ankesat dorëzohen në kopje fizike në ABGJ- ZKM kati i VII zyra 711.

Rezultatet nga lista preliminare shëndrrohen në rezultate përfundimtare pasi të jenë kryer të gjitha procedurat dhe afatet e parapara me rregulloren 04/2017.

ANËTARËT E KOMISIONIT


Leonora Selmani




Shpresa Zariqi



Jehona Xani



Yllka Buzhala



Brikena Avdyli

